



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 350/2 Prot.

Tiranë, më 08. 04. 2025

**V E N D I M**

Nr. 81, datë 08. 04. 2025

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”<sup>2</sup>, të ndryshuar, shqyrtoi ankesën 43, datë 20.02.2025 të znj. H. S. kundër Ujësjetllës Kanalizime sh.a, Elbasan, në të cilën pretendon se është diskriminuar për shkak të “*gjendjes ekonomike, familjare*” dhe “*përgjegjësisë prindërore*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: *Ankuesja, H. S., është banore e qytetit të Elbasanit, pensioniste, kryefamiljare dhe e ve që nga viti 2016. Para disa ditësh, në banesën private të ankueses, kanë ardhur disa punonjës të UKE-së, të cilët i kanë njoftuar se do t’i ndërpresin furnizimin me ujë të pijshëm, pasi ajo është debitore (faturat janë në emër të bashkëshortit të ndjerë, G. S). Për këtë arsye, ankuesja i është drejtuar UKE-së me kërkesë për ndihmë më datë 18.02.2025, por nga përfaqësuesit e UKE-së ka marrë përgjigje se për të rifilluar furnizimin me ujë, ajo duhet të paguajë një shumë prej 90,000 lekësh në fillim dhe 3,000 lekë çdo muaj, si pjesë e një marrëveshjeje për detyrimet e prapambetura, përveç faturave të ardhshme të konsumit të ujit.*

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

*Ankuesja ka informuar se nuk ka mundësi të paguajë 90,000 lekë dhe marrëveshjen për pagesë mujore prej 3,000 lekësh, pasi është pensioniste, kryefamiljare dhe e ve, dhe jeton me një pension prej 15,000 lekësh në muaj. Ky pension i shërben vetëm për të mbuluar shpenzimet e nevojshme për ushqime, ilaçe dhe pagesën e energjisë elektrike. Kështu, shumën prej 15,000 lekësh që merr çdo muaj, jo vetëm që nuk i mjafton për të paguar detyrimet e kërkuara nga UKE, por gjithashtu është më e ulët se minimumi jetik për të mbijetuar, sipas vlerësimeve dhe llogaritjeve të bërë nga Avokati i Popullit në raportet e tij.*

*Siç është theksuar më parë, ankuesja H. S., është në një gjendje të vështirë ekonomike, jeton në një banesë të vjetër, është e vetme, kryefamiljare dhe e ve, dhe ka një pension prej 15,000 lekësh në muaj. Ajo është 68 vjeç dhe vuajta nga sëmundje të tilla si diabeti. Në këtë moshë të thyer, ajo nuk mund të qëndrojë pa ujë të pijshëm, duke pasur parasysh se ujësjellësi dhe kanalizimet janë monopolistë dhe ofrojnë ujë si shërbim të vetëm. Të gjitha këto kushte përbëjnë një kundërshtim të drejtpërdrejtë me ligjin, si dhe me dispozitat e KMD-së dhe KEDNJ-së, duke marrë parasysh gjendjen e saj ekonomike, shëndetësore dhe familjare.*

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndihmojë në lehtësimin e procedurave për lidhjen e aktmarrveshjes për furnizimin me ujë. Ankuesja të përjashtohet pagesa e menjëhershme fillestare prej 90,000 lekësh, si dhe pagesa mujore prej 3,000 lekësh për aktmarrveshjen. Nga ana e ankueses, H. S., të paguhet një shumë simbolike për aktmarrveshjen prej 500 lekësh në muaj, përveç faturës aktuale që do t'i vijë çdo muaj. Si fillim, të paguhet një faturë nga viti 2024 dhe një faturë nga viti 2025, dhe më pas të paguhet fatura aktuale së bashku me 500 lekë për aktmarrveshjen çdo muaj. Për këto qëllime, është mbajtur në konsideratë vendimi nr. 203, datë 09.11.2022, i marrë nga KMD, ku UKE ka pranuar që ankuesi të paguajë një aktmarrveshje prej 500 lekësh në muaj.

### **Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të LMD, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Shkaqet e diskriminimit të pretenduara nga ankuesit, mosha dhe raca, janë shkaqe të mbrojtur nga neni 1, i LMD, ku parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Sipas nenit 3, pika 1, të LMD, të ndryshuar, përcaktohet se: *“1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji,*

*që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në Kreun IV, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, germa a) parashikon shprehimisht se: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji...”*

Sipas nenit 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në kushtet kur, kur nga ankuesja nuk na ishte vënë në dispozicion një dokument ligjor i cili vërtetonte shkakun e pretenduar për diskriminim, me shkresën nr.350/1 prot., datë 27.02.2025 të Komisionerit, u kërkua informacioni i mëposhtëm:

- Shpjegime të hollësishme mbi shkaqet e diskriminimit të pretenduar në ankesë dhe si kanë ndikuar këto shkaqe në kryerjen e sjelljes diskriminuese. Ky informacion duhet të shoqërohet me fakte dhe prova konkrete që vërtetojnë se ju i mbartni këto shkaqe të pretenduara.
- Vertetim që ju trajtoheni me pension pleqërie dhe vlerën e tij, të lëshuar nga institucioni përkatës.
- Kopje e faturës së Ujësijellës Kanalizime sh.a, Elbasan, ku ju figuroni si debitore (kopja duhet të jetë e qartë).
- Informacion nëse keni paraqitur ankesë pranë Ujësijellës Kanalizime sh.a, Elbasan; nëse po, ju lutemi të na vini në dispozicion kopje të përgjigjes së kthyer.
- Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju do ta gjykoni të nevojshëm në mbështetje të ankesës tuaj.

Sa sipër, nga ana e ankueses nuk është marrë asnjë përgjigje dhe nuk është plotësuar asnjë nga dokumentacionet e kërkua nga Komisioneri me shkresën nr. 350/1 prot., datë 27.02.2025. Ndërkohë sipas fletës së Lajmërim Marrjes nr. RR 764 655 265 AA të Zyrës Postare, ankuesja është lajmëruar, ajo ka lënë zarfin postar pa e tërhequr.

Duke marrë shkas nga mosmarrja e dijenisë nga ankuesja për kërkesat e Komisionerit për trajtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, inspektori i çështjes me email-in e datës 12.03.2025 i ka kërkuar dhe njëherë informacion ankueses, duke i dërguar përsëri shkresën nr. 350/1 prot., datë 27.02.2025.

Me email-in e datës 12.03.2025, nga ana e ankueses është përcjellë një Deklaratë për heqje dorë nga ankesa nr. 43, datë 20.02.2025, në të cilën ajo ka shprehur se: *“Nëpërmjet këtij email-i, ju bëj me dije se do të tërhiqem nga ankesa ime, pasi e kam zgjidhur atë në mënyrë individuale. Ju faleminderit.”*

Neni 33, pika 7/1 e LMD, ka parashikuar se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër.

Sa më sipër, pala ankuese duhet të paraqesë fakte dhe prova që mbështesin pretendimin e saj për diskriminim. Në këtë rast, ankuesja nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimin e saj për diskriminim, dhe ka hequr dorë nga ankesa.

Vetëm pasi pala ankuese të paraqesë fakte dhe prova të mjaftueshme, barra e provës kalon tek pala e paditur, e cila duhet të provojë se veprimet e saj nuk përbëjnë diskriminim. Kjo është një detyrim ligjor i palës tjetër (*p.sh., Ujësjellës Kanalizime sh.a, Elbasan*), që duhet të vërtetojë se trajtimi i ankueses nuk ka qenë diskriminues, duke ofruar prova dhe argumente që mbështesin legjitimitetin e veprimeve të saj.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”*

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet përfundimi i procedurës administrative: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, përcaktohet: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi*

*publik deklararon përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.*

Në këto kushte, kur pala që ka iniciuar ankesën ka hequr dorë nga ankesa e saj, nuk ka asnjë arsye që justifikon vazhdimin e procedurës administrative. Pasi ankuesja ka tërhequr ankesën në mënyrë zyrtare dhe ka shprehur vullnetin për të mos e vazhduar, nuk ka më asnjë element ligjor ose procedural që justifikon mbajtjen hapur të çështjes. Prandaj, procedura duhet të mbyllet dhe të deklarohet e përfunduar, duke pasur parasysh se nuk ka më një ankesë aktive nga pala ankuese.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës, duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa 43, datë 20.02.2025 kundër Ujësjeles Kanalizime sh.a, Elbasan, për shkak të “*gjendjes ekonomike, familjare*” dhe “*përgjegjësisë prindërore*”, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe nenet 32 e 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarohet të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 43, datë 20.02.2025, pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Konceptoi: L. Jani  
Miratoi: V. Bushati  
Datë: 14.03.2024

